

VËZHGIME NGA FESTIVALI MBARËKOMBËTAR SHQIPTAR I FOLKLORIT

Rapsha 2017, Tuz, Mali I Zi (18-20 Gusht)

Në këtë festival u ftova me detyrën e **anëtarit të jurisë, nga Lucë Juncaj**, drejtori i Këshillit Organizativ të Festivalit, njëherësh kryetar i SHKA "Rapsha" të Tuzit – Malësi e Madhe, si nikoqirja dhe manaxherja e asaj veprimtarie.

Në festival morën pjesë **22 grupe, shoqata apo ansamble folklorike fhqiptare**, që përfaqësonin shtatë shtete: **Shqipëria** (me 7 ansamble), **Kosova** (5 ansamble), **Maqedonia** (2 ansamble), **Mali i Zi** (4 ansamble), **Italia** (1 ansambël), **Serbia** (1 ansambël), **SHBA** (2 ansamble).

Festivali, siç shihet edhe nga titulli, ishte i **përmasave folklorike – burimore me krijimtari shpirtërore të anonimatit**. Si i tillë, ai pati **karakter garues**, për të cilin ishte ngritur edhe **juria profesionale**. Klasifikimit konkurrues iu nënshtruan 20 ansamble, teksa vetëm dy patën *funksion përshëndetës: nikoqirët, SHKA "Rapsha", Drume – Hot dhe ansambli kombëtar "Shota", Prishtinë – Kosovë*.

Sipas rregullatorit të Drejtorisë së Festivalit, çdo ansambël do të konkurronte në *15 minuta dhe programi duhej të ishte me shoqërime muzikore të drejtpërdrejta dhe jo me incizime (CD)*. Përmbajtja e programit duhet të ishte sa më burimore, duke i bërë jehonë kryesisht autenticitetit vendës. Gjithashtu, kërkohet që kostumet popullore të ishin sa më origjinale.

"Festivali Mbarëkombëtar i Folklorit Rapsha 2017 – Malësi e Madhe" shënoi edicionin e 5-të të mbajtjes së tij. Ky festival zhvillohet një herë në katër vjet, duke nisur me të parin më 2003, të dytin – 2005, të tretin – 2009, të katërtin – 2013 dhe i pesti ky, objekt.

Tradicionalisht, festivali mbahet në kompleksin natyror Vitojë, 5-6 km në hyrje të rrugës automobilistike për në Tuz. Vitoja shërbente edhe si njëfarë rezidence për veprimtaritë e SHKA "Rapsha", Malësi e Madhe. Ajo personifikon një amfiteatër, me gurgullima ujore të

nëndheshme dhe blerime fushore-bregore, të cilat e pasurojnë festivalin me një pamje vlerash të mahnitshme.

Refleksionet për festivalin do të shqyrtohen sipas rendit kronologjik gjatë tri mbrëmjeve.

Mbrëmja e parë

Sipas programit, në ora 18 00, të shtatë ansamblet pjesëmarrëse të mbrëmjes së parë, u mbledhën në QKI "Malësori" në Tuz për të zhvilluar **defilenë e ansambleve** (apo "Paradën e nisjes").

Si kudo në raste të tilla, edhe Tuzi shndriti nga një festivitete i madh popullor përmes tingujve të zurleve, ritmit të tupanëve, këngëve dinamike, apo ngjyimeve marramendase të kostumeve popullore. Përmes një organizimi të shkëlqyer, kolona e pambarimtë e ansambleve, të ftuarve dhe spektatorëve, gjurmuan në atë "marshim pesëkilometërsh", duke jehuar fushat dhe kodrinat e Hotit të Malësisë, për të vijuar në Vitojë, amësia e zhvillimit të festivalit.

Në çdo cep të Vitojës ndjehej lëvizje dhe gjallëri e madhe. Ama, përmes një rregulli të veçantë, secili gjente ulësen e vet (pa biletë) dhe të gjithë, kryesisht familjarë, gra e burra, të moshuar dhe fëmijë, kudo nga ato anë, krijonin një tablo rrezatuese, teksa në çdo mbrëmje mund të ishin të pranishëm rreth 7-8 mijë spektatorë.

Pas fjalës përshëndetëse të mirëseardhjes, drejtori Lucë Juncaj e deklaroi të hapur edicionin e 5-të të "Festivalit Rapshta - Malësi e Madhe, 2017".

Me ovacione marramendëse nis kështu mëkimi i tharmit popullor të ansambleve garuese dhe përshëndetëse.

Ansambli i parë

SHKA "Rapshta", Drume-Hot. Sipas programit, festivalin e çeli nikoqiri, ansambli "Rapshta", i cili ishte me funksion përshëndetës, pra jo me të drejtë konkurrimi.

"Rapshta" përbën një rënë ndër ansamblet me emër të trojeve shqiptare në Malin e Zi. Është pjesëmarrës në shumë festivale folklorike në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e gjetkë, sikundër edhe në festivale ndërkombëtare, duke krijuar reputacion të pasur. Është fitues i shumë çmimeve festivalistike.

Repertori i këtij ansambli në festivalin e sivjetshëm, me valle të tilla brilante, si: "Kcimi i lutut" dhe "Premja me tagana", këngët e

instrumentalet karakteristike, dhe posaçërisht me veshjen – xhubletën e madhërishtme, krijuan një tablo mirëseardhjeje artistike joshëse dhe relaksuese.

Do të përbënte interes të posaçëm fakti se, sipas të dhënave, një ansambël me të njëjtin emër, “Rapsha”, qenka ngritur dhe zhvillokërka veprimtari folklorike në diasporën e Nju Jorkut të SHBA-së, me pjesëmarrës kryesisht të origjinës vendase, nga Malësia e Madhe.

Ansambli i dytë

Ansambli kombëtar “Shota”, Prishtinë – Kosovë. Ashtu si “Rapsha”, edhe “Shota” nuk konkurronte, ishte përshëndetës.

Si kurdoherë, duke veçuar edhe këtë minikoncert, “Shota” u paraqit denjësisht me përmasat e një ansambli të mirëfilltë profesionalo-artistik, njëherësh përfaqësues legjitim i këngëve dhe valleve popullore kosovare.

Ansambli i tretë

“Krahu i Shqiponjës Taip Medani”, Vlorë – Shqipëri. Ky ansambël do të përfaqësonte të parin konkurrues në festivalin “Rapsha 2017”.

Njihet në Shqipëri kryesisht si trajtues i këngëve dhe valleve popullore çame, të çamëve që banojnë në qytetin e Vlorës.

Ansambli “Krahu i Shqiponjës Taip Medani” është krijuar në vitin 1978. Ka marrë pjesë në të gjithë edicionet e “Festivalit të Këngëve dhe Valleve Çame”, të zhvilluara në Sarandë; festivalit “Sofra dardane”, të mbajtura në Tropojë; Festivalit Mesdhetarë Ndërkombëtarë, të realizuara në qytetin e Vlorës. Gjithashtu, është pjesëmarrës me sukses në festivale ndërkombëtare, si: Bullgari, Maqedoni, Itali, Kosovë dhe Turqi.

Në festivalin “Rapsha 2017” konkurroi me dy nga perlat e koreografisë popullore shqiptare në përgjithësi dhe të Çamërisë në veçanti. Janë të njohurat: “Tumankuqja” (valle grash) dhe “Osman Taka” (valle burrash).

Ansambli i katërt

SHKA “Sali Mani” Malësia e Madhe, Shqipëri. Përmes edhe emrit që mban, të një këngëtarit shumë të njohur në Malësinë e Madhe të Shkodrës, të ndjerin Sali Mani, dihet tashmë se ai

ansambël ka krijuar reputacion brenda dhe jashtë Shqipërisë, duke u lauruar me shumë çmime.

Sipas programit, shquajtën njësitë: *“Këngë majekrahu”, “Kcimi i logut”, që me keqardhje nuk ruan “lojën e heshtur”, por përcillet me dy çifteli, “Kangë me lahutë”, “Kangë me çifteli”, “Kangë dyshe malsorçe”, “Kanga e bareshës”, teksa e fundit u mirëprit dukshëm etj.*

Repertori i programit përgjithësisht shquajti për maturi burimore, sigurisht edhe me nuancime të një karakteri artistik bashkëkohor.

Ansambli i pestë

“Burimet e Sharrit”, Tetovë – Maqedoni. Përfaqëson një ansambël folkloriko-artistik me përvojë të gjatë skenike. Është themeluar në vitin 1996, duke marrë pjesë së shumti në festivale folklorike kombëtare, mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare, çka është vlerësuar edhe me çmime.

Në repertorin e programit u trajtuan njësi të tilla, si: *“Kangë djepi – ninullë”, “Riti i ndjelljes së bletës”, vallet “Krah më krah” dhe “Brez pas brezi”, si edhe një “Kolazh me lojra popullore”. Posaçërisht “lojrat” sollën ndjesi humoristike dhe kërshtëri zbavitëse. Po ashtu spikati edhe “bleta”, kurse vallet qenë më së shumti të përpunuara (pra jo të kornizës festivalistike), ndonëse ekzekutuesit e rinj premtojnë për cilësi burimore.*

Ky ansambël, si edhe herë të tjera, pati rritje të shpejtësisë së lëvizjeve, kryesisht në fundet e valleve, sikurse edhe rrethrotullimet e shamijave, më së shumti nga i pari i grupit të valltarëve, mjete shprehëse këto të cilat e plasarin etnitetin burimor të kërcimeve shqiptare.

Ansambli i gjashtë

SHKA “Maja e karafilit”, Plavë-Guci, Mali i Zi. Përbën një grup sa modest aq edhe të këndshëm. Është themeluar në vitin 1990, duke marrë pjesë në veprimtari festivalistike në Shqipëri, Kosovë dhe Malin e Zi. Shquan për organizimin e festivalit mbarëkombëtar *“Kënga dhe vallja shqipe na bashkon”.*

Programi i përshtatet mirë fizionomisë së festivalit për trajtesa të folklorit burimor. Për këtë dëshmon më së miri vallja e vajzave e përcjellë me këngën tradicionale *“Hoj, dodo, hoj”.* Shquajtën edhe

njësitë “Kangë vajzash” dhe “Valle – kangë festive”. Në të kundërt, koreografia “Plaga e mërgimit”, pavarësisht nga niveli artistik, ndonëse edhe me bulëza natyralizmi, përfaqëson sajësë apo ngërç folklorik, duke u ravijëzuar me sferat e përpunimit apo stilizimit, pra jashtë standardeve festivalistike të edicionit të 5-të, “Rapsha 2017”.

Ansambli i shtatë

SHKA “Gryka e Kaçanikut”, Kaçanik – Kosovë. Është themeluar në vitin 2004 mbi trashëgiminë e ansamblit 68-vjeçar “Përparimi” të Kaçanikut. Ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha festivalet folklorike të zhvilluara në Kosovë, si edhe në të tillë në Shqipëri, Maqedoni etj.

Sipas programit, ky ansambël është i maturuar nga festiviteti dhe gjallërimi në të ekzekutuarit e këngëve dhe valleve. Kam mendimin se më së shumti ato luhasin nga sfera e përpunimit, kryesisht në fushën e koreografisë.

Fuqishëm dhe me emocione u transmetua vallja masive “Ushton gryka e Kaçanikut” gjatë hapjes së koncertit. Ajo u përcoll muzikalisht me këngën aq të popullarizuar me të njëjtin titull, e cila ravijëzon pothuajse njëfarë lajtmotivi të këndshëm për fizionominë e atij ansambli.

Mbrëmja e dytë

Ashtu si një mbrëmje më parë, fillimisht zhvillohet “Drefileja e ansableve” në qytetin e Tuzit. Në ora 2000 nisën koncertet e dyta konkurruese të shtatë ansambleve folklorike në Vitojë të Tuzit.

Ansambli i tetë

SHKA “Dedë Gjon Luli”, Traboin – Hot, Mali i Zi. Përbën një ansambël të konsoliduar me performancë rrezatuese. Është themeluar në vitin 2002 dhe ka ligjëruar pjesëmarrje të suksesshme, deri në çmime të para nëpër festivale të ngulimeve shqiptare në Malin e Zi, Kosovë etj.

Një ansambël si “Dedë Gjon Luli”, meriton vlerësime posaçërisht për **xhubletën** e veshjes së grave, një himn ky i kostumografisë dhe përgjithësisht i kulturës sonë kombëtare, për të cilën u prononcova qysh në paraqitjen e saj të parë me ansamblin “Rapsha”.

Në programin e këtij ansambli spikati për shumë mirë tradicioni perlë i vallëzimit në dy grupe vijëdrejtë, vajzash dhe djemsh përballë njëri me tjetrin, duke u alternuar me hapa të thjeshta drejt qendrës. Pati mirësi edhe përcjellja muzikore me këngë nga vetë pjesëmarrësit. U paraqit mirë edhe kënga *“Ka shkrue fjalë”*, kënduar nga Lulë Nicaj dhe Marash Dushaj, si edhe melodia orkestrale nga grupi. La për të dëshiruar *“Kcim tradicional malsor”*, interpretuar me shpata nga Agron Gojçaj dhe Lulë Nicaj. Do të dëshironim që të paktën të ruhej emërtimi tradicional i kësaj valleje të lashtë në mbarë ngulimet e Malësisë së Madhe, *“Premja me taganë”*. Sakaq, nuk do të ishte i pranueshëm fakti që të kënga *“Delja rudë”* përcjelljen me të rrotulluarit e tepsisë ta bënte një burrë, kur tradita për një funksion të tillë rrvijëzon vetëm gruan.

Ansambli i nëntë

“Shkëmbi” dhe “Shkëndija” të katundeve arbëreshe Akaaformoza dhe San Benedeto Ullanova, Itali. Siç duket edhe nga titulli, janë dy ansamble arbëreshe që në festivalin *“Rapsha 2017”* u paraqitën në një të vetëm. Në fakt, këngët e programit u kënduan nga grupi *“Shkëmbi”*, kurse vallet nga *“Shkëndija”*.

Veprimtaritë folkloristiko-artistike të këtyre dy grupeve për mëse 20 vite, sipas njohurive të mia, gjallojnë përmes kontekstesh të ndryshme, kryesisht nëpër ngulimet arbëreshe: Kalabri, Bazilikata, Pulia, Melisë, Sicili e gjetkë të Italisë.

Programi ruan emërtimet e tradicioneve autentike të këngëve dhe valleve, si: *“Zëmi vallen”*, *“Kur të pash”*, *“Skandërbeku”*. Ato i bëjnë jehonë më së shumti ritualit të nusërisë dhe dasmës në përgjithësi, sikundër edhe dashurisë, punës në arë etj.

Arbëreshët kënduan dhe vallëzuan modestisht mirë, sipas tradicionit përkatës, ndaj u pritën me bujari nga spektatorët shqiptarë në Malin e Zi, por edhe nga diaspora e malësisë vendase.

Ansambli i dhjetë

Grupi polifonik “Lunxhëria”, Lunxhëri-Shqipëri. Janë shumë kuptimplote të dhëna të tilla, si: pjesëmarrës në të gjithë festivalet folklorike kombëtare të zhvilluara në Gjirokastër, po ashtu në gjashtë edicione të *“Oda dibrane – Shqipëri”*, në dy të tilla në Kosovë etj. Veçojnë veprimtaritë folklorike ndërkombëtare në Greqi, Republikën çeke, Sllovakia, Belgjikë etj.

Grupi polifonik "Lunxhëria" lëvroi në festival një program burimor të larmishëm. Të tilla qenë këngët aq të njohura, si: "Lunxhëri plot lezete", "Hiqe vallen shtruaro", "Në valle u zu qeleshi", "Motive dasme lunxhiote", "Dy bejka çokanë frenga" etj.

Të kënduarit polifonik të këtij ansambli përkon me profesionalizëm të përsosur. Këngët mëkuan përmes zërave të grave dhe të burrave me tingëllime ngjyrimesh ogurmire dhe nga të tharmit popullor, të një anonimati të kristalizuuar. Adhurimin dhe përsosmërinë ky ansambël e ka të stazhionuar edhe nga veshja e grave, kostumi i Lunxhërisë, një oaz ky i vlerave të patjetërsueshme jo vetëm në rang kombëtar, por të tillë edhe europian, mbase edhe më gjerë. Vlerën e tij do ta shpinte më tej, pse jo, edhe rasti analog me xhuble të famshme të Malësisë së Madhe, duke u ravijëzuar kështu dy monumente imponante të kulturës sonë kombëtare.

Ansambli i njëmbëdhjetë

Ansambli etnokulturor "Katerina Josipi", Zym - Prizren, Kosovë. Është themeluar në vitin 1970, me emrin e të madhes, aktorese së parë shqiptare nga Zymi i Hasit, Katerina Josipi.

Ky ansambël është etiketuar tashmë në suazën etnokulturore, duke u ligjëruar si *Qendra Kulturore dhe Arsimore e Rajonit të Hasit. Maturia e këtij institucioni është sintetizuar me ngritjen e klubit letrar "Shtjefën Gjeçovi", posaçërisht përmes manifestimit letraro-kulturor e shkencor "Takimet e Gjeçovit" në Zym të Hasit.*

Ansambli etnokulturor "Katerina Josipi" i Zymit, ka marrë pjesë në veprimtari të shumta kulturoro-artistike në Kosovë, Shqipëri, te shqiptarët në Maqedoni e në Malin e Zi, dhe në mbarë ngulimet shqiptare kudo në botë. Po ashtu, e dukshme është edhe pjesëmarrja në veprimtari ndërkombëtare.

Objekte folklorike dhe kulturore të këtij ansambli janë: defi, lodra, fyelli, kavalli, bishnica; apo idile të tilla, si: ritet e punës, të kulaçit të nuses, të grishtarit, ditët e kurbetqarëve; sikundër edhe ritet e festave të Pashkëve, Bajramit etj.

Ansambli "Katerina Josipi" është shpërblyer me shumë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare të tilla për: paraqitjen skenike, vallet dhe këngët, veshjen tradicionale, ritualin e lindjes dhe të martesës, instrumentet popullore etj. Me këtë rast do të veçoja fituesin e çmimit të parë në festivalin mbarëkombëtar "Rapsha 2009".

Formimi kulturor i këtij ansambli u mishërua edhe nga programi që u paraqit, i cili ishte dinjitoz. Vlerësimin parësor do ta kisha për të quajturën “Valle me gojë e vajzave” (dy bartëse), e cila në shkencën koreografike shqiptare përfaqëson një vallëzim burimor, i luajtur nga një grua që kërcen e ulur galiç, përmes përcjelljes vetë me të përftuarit apo artikulimit të tingujve: “fësh, fësh...”. Të dukshme qenë në program edhe “Nata e kanagjegjit”, loja popullore “Fluturon zogu”, një kërcim grash të moshuara etj. Padyshim që surprizë do të rrvijëzonte **kostumi i grave zymjane me atë gjithfarë bukurie dhe performance rrezatuese.**

Ansambli i dymbëdhjetë

Shoqata Kulturore “Skampa”, Elbasan-Shqipëri. Është themeluar në vitin 2008 me disa formacione artistike, ku shquan ansambli i këngëve dhe valleve popullore “Skampa”. Përveçse brenda ngulimeve shqiptare, ka marrë pjesë me sukses në veprimtari ndërkombëtare, si: Greqi, Itali, Bullgari, Rumani, Mali i Zi, Maqedoni, Kosovë etj.

Në festivalin e sivjetshëm u paraqit me një program dinjitoz, përmes tri valleve, një kënge dhe një orkestraleje. Spikati formacioni instrumental me në krye klarinetistin e shquar **Dritan Mustafaj**, i cili luajti si solist në një orkestrale, sikundër edhe si këngëtar. Mirë u paraqitën edhe “Valle dasme të qytetit të Elbasanit” dhe “Valle me motive të Malësisë së Elbasanit”. Nga grupi i valleve që i ekzekutoi ato, vajzat u paraqitën më mirë për nga ekzekutimi dhe interpretimi i lëvizjeve dhe figurave koreografike, ndërkohë që djemtë nuk e patën atë performancë. Me keqardhje, përgjithësisht në të dyja vallet e programit u ndien “vërshime” të shumta lëvizjesh dhe figurash, njëherësh ngarkesa të panevojshme. Me më pak të tilla sigurisht që do të krijohej thjeshtësi dhe bukuri, sikundër do t’i përshtateshin stadeve burimore, siç qe festioali.

Në programin e këtij ansambli përbën veçanti “Valle me motive çame”, e trajtuar për afërsisht brenda konceptionit burimor çam. Do të meritonte lëvdata të pakursyera valltari solist në vallen “Osman Taka”. Një virtuozeitet i tillë (edhe pse do të duhej të ishte paksa më i përmbajtur në ndonjë element kërcyes-akrobatik), i surprizoi të pranishmit. (Me këtë rast: kujdes ndonjë fustanellë e shkurtër sipër gjurit e cila na shpie...).

Ansambli i trembëdhjetë

“**Guerra e Kurbinut**”, **Laç - Shqipëri**. Është themeluar në vitin 1992 dhe ka marrë pjesë në disa veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, duke u vlerësuar edhe me çmime.

Në këtë ansambël shquajti pjesëmarrja e bartësit veteran **Pal Dedgjoni**, në lojën me tri instrumente aerofone: *bri, bilbil dhe zumare*. Në këtë spektër ai njihet si një mjeshtër edhe në fushën e përgatitjeve të instrumenteve popullore, i vlerësuar si prodhimtar i zoti nga studiues të organologjisë shqiptare. Ky bartës i surprizoi të pranishmit, ashtu si gjithmonë në tubime të tilla folklorike në Shqipëri. Këtë radhë veçon pjesëmarrja e tij, ngase luajti edhe bashkë me të nipin, **Vigen Dedgjoni**, duke u ravijëzuar kështu një vizion i këndshëm transmetimi brezash.

Programi i “*Guerra e Kurbinut*” spikati edhe me këngën “*Albulena*”, e kënduar nga grupi i burrave, si edhe këngët “*Betimi i vashave të Kurbinut*” dhe “*Qani ju zymbyla, këndon ju bylbyla*”, të interpretuara nga grupi i vajzave. Programi përmbante edhe “*Valle vendi të Kurbinut*”, të cilën e ekzekutoi grupi i vajzave. Ndryshe nga këngët, vallja përgjithësisht ishte anemike si për nga të konceptuarit (!), ashtu dhe nga të kërcyerit (Për më tej: çne lodra në një formacion muzikor të Kurbinut!).

Ansambli i katërbëdhjetë

SHKA “Zëri i Luginës”, Bujanoc, Lugina e Preshevës - Serbi. Është themeluar në vitin 2007, duke u angazhuar në disa veprimtari folklorike mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare. Për festivalin “*Rapsha 2007*” dhe përgjithësisht për kulturën tonë kombëtare, ky ansambël paraqet interes të veçantë ngase personifikon tri ngulime të konsiderueshme shqiptarësh: *Preshevën, Bujanocin dhe Medvegjën*, të njohura historikisht dhe etnografikisht si “*Lugina e Preshevës*” apo *Kosova Lindore*. Qenë këta faktorë që programi e atij ansambli u ndoq me kërshtëri të madhe.

Ndërkaq, “*Kanagjegji i vajzës*”, që shënoi nismën e programit, u këndua këndshëm duke i bërë jehonë një rituali tradicional me një lirikë brilante. E një sferë të tillë që edhe “*Vallja e nuses dhe temenaja*”, ndonëse përmes një sferë tjetër, siç është të kërcyerit, që në këtë rast u materializua hijshëm edhe nga elemente të plastikës pantomimike.

Në program pati edhe dy njësi të mirëfillta nga fusha koreografike. E para, “*Vallja e topallit*” dhe “*Vallja e Maramës*”,

të cilat u trajtuan mirë sipas sferës së repertorit tradicional të atyre ngulimeve shqiptare. Nuk do të kisha konsiderata të tilla për njësinë e dytë, po me dy njësi kërcimi, "Vallja e Gjilanit" dhe "Valle e kombinuar" (për nga emërtimi!), të përcjella të dyja nga një formacion tradicional, me dy zurlë dhe një tupan.

Shqetësimi në këtë rast qëndron ngase në fundet e valleve, duke përfshirë edhe njësinë e sipërtrajtuar, **shpejtohen lëvizjet e këmbëve** aq shumë saqë nuk e ruajnë më shtratin e karakterit plastik të koreografisë popullore shqiptare, por shndërrohen në një të tillë, me karakter ritmik, që i përket fizionomisë së kërcimeve sllave (!). Të një natyre të tillë qenë edhe lëvizjet rrethrotullore të shamisë kryesisht nga korifeu, por në vijim edhe nga pjesëtarët e grupit. Sa për kujtesë, në traditën e valleve popullore shqiptare *shamia lëviz lehtë dhe gjerë, me njëfarë përkëdheljeje dhe jo mekanizmi vulgar (!)*. Dukuri të tilla janë cekur edhe më sipër, tek ansambli i pestë, "Burimet e Sharrit", Tetovë.

Pavarësisht nga sa u tha, programi i SHKA "Zëri i Luginës" - Bujanoc ishte gjurmëlënës dhe si i tillë u duartrokoi me dashamirësi nga të pranishmit dhe posaçërisht nga diaspora vendase.

Mbrëmja e tretë

Ashtu si në të dy mbrëmjet e para, pas Defilesë nëpër Tuz, nisin konkurrimet e tetë ansambleve folklorike në Vitojë të **Tuzit**.

Ansambli i pesëmbëdhjetë

SHKA "Besa", Triesh, Malësi e Madhe - Mali i Zi. Përbën event fakti se ky ansambël shënon të katërtin pas "Rapshës", shoqatës "Sali Mani" dhe SHKA "Dedë Gjon Luli", të cilat kanë në zotërim xhubletën e Malësisë së Madhe, himnin kostumografik shqiptar.

Ky ansambël është themeluar në vitin 1968. Ka marrë pjesë në disa veprimtari folklorike kombëtare dhe ndërkombëtare. Përgjithësisht përfaqësohet me vlera folklorike modeste. Gjatë programit u trajtua shumë mirë kënga me lahutë "Muji dhe zanat e malit", nga bartësi **Rrok Prenkoçaj**. Po ashtu shquajtën "Kangë majekrahi" nga **Anton Nikprelaj dhe ritet baritore** "Po çka ka lkuqja që blegron", kënduar nga **Shaqe Lucaj**, përcjellë me fyell nga **Lekë Memçaj**.

Posaçërisht meriton të vlerësohet "Riti mort", një tradicion i lashtë ky me vlera folkloriko-dramatike të një rëndësie të veçantë. E

interpretoi me mjeshtëri një grup burrash të atij ansambli, ndërkaq që e "udhëhoqi", siç thuhet në raste të tilla, bartësi **Lekë Memçaj**. Mendoj se personifikimi i "kufomës" krijon njëfarë natyralizmi folklorik, teksa mund të operohej fare mirë përmes "sikurit skenik". Kaq do të ishte përsëmirë lidhur me "Ritin mort".

Në të kundërt, koreografia në ansamblin "Besa" - Triesh, pati luhatje. Sakaq, "Vallja e mejdanit" ("Presja me taganë", R.B.), la shumë për të dëshiruar, teksa ajo personifikon një perlë të çmuar të traditës folklorike shqiptare. Dobët u interpretua edhe njëfarë montazhi i titulluar: "Gocja", "Vallja e Malsisë" dhe "Vallja e logut". Edhe në këto raste pati shfaqje të njëfarë ngërçi natyralizmi.

Ansambli i gjashtëmbëdhjetë

"Gjergj Kastrioti - Skënderbeu", Detroit - Miçigan, SHBA. Ky ansambël nga diaspora shqiptare e Amerikës, ashtu sikundër edhe tjetri në vijim, "Bashkimi kombëtar" i Nju Jorkut, u pritën me brohoritje të mëdha, ngase pjesëmarrësit e tyre janë më së shumti me origjinë nga trojet shqiptare të Malësisë në Malin e Zi.

Repertori i programit të këtij ansambli nuk përkoi sa duhet me kornizën e një festivali me këngë dhe valle burimore. Ato, më së shumti, qenë të një karakteri përpunues me kompozime koreografike të kahjeve bashkëkohore. Si të tilla përgjithësisht u kërcyen mirë, teksa një duet koreografik la mbresa të pashlyeshme. Pjesëmarrësit, këngëtarë - valltarë, përgjithësisht ishin të rinj, si: **Lekë Gjoka, Daniela Ndrecaj, Gabriela Ndrecaj, Melisa Marku, Mark Sinishta, Alban Gjela etj.** Shquajti për një punë interesante, koreografja, njëherësh drejtuese artistike, **Joli Paparisto**.

Ansambli i shtatëmbëdhjetë

Ansambli folklorik "Mati", Mat - Shqipëri. I ka nisur veprimtarinë folklorike në vitet '50 të shekullit të kaluar, duke u cilësuar si njëri ndër ansamblet folklorike shqiptare me një reputacion të konsiderueshëm.

Programi i ansambilit u mirëprit për vlerat e pasura burimore dhe interpretimin e përsosur. Si kurdoherë ndriçoi "Vallja e kënduar grarishte" e fshatit Guri i Bardhë të Matit. Gratë valltare - këngëtare luajtën me origjinalitet të veçantë, përmes një elegancë dhe finesë të lëvizjeve kërcyese dhe të kënduarit me ndjeshmëri.

Orkestralja me instrumente popullore shkëlqeu për nga njëfarë simfonizmi me ngjyrimë rrezatuese nga tradicioni muzikor vendës. Një njësi e tretë pikante ishte *“Kangë gurbeti”*, kënduar nga **Xhevrije Vata, përcjellë me lauri nga Xhulio Barjoti. Po ashtu, me dinjitet u ekzekutua “Kolazh me kangë dasme matjane” nga i gjithë grupi.**

Ansambli i tetëmbëdhjetë

SHKA “Malësori”, Gjonaj - Prizren, Kosovë. Është bërë shumë i njohur për organizimin e institucionit aq të popullarizuar në Kosovë, festivali folklorik *“Hasi jehon”*, nga viti 1976. Shquan për pjesëmarrje me dinjitet në shumë veprimtari folklorike kombëtare dhe ndërkombëtare. Kultivon me fanatizëm folklorin burimor të atij thesari të çmuar të identitetit tonë kulturor e kombëtar. Vlen të vlerësohet fakti se SHKA *“Malësori”*, prej vitit 2002 është i binjakëzuar me SHKA *“Rapsha”*. Mesa e njoh këtë ansambël, një meritë të madhe për arritje të sukseshme dhe posaçërisht për organizimin e festivalit *“Hasi jehon”* në çerdhen e atij festivali, fshatin Gjonaj, ka përgjegjësi i përkushtuar **Haziz Hodaj.**

Në repertor shquajtën: *“Valle grash katërshe”*, *“Hajredin Pashë”* – melodi me dy zurla e dy tupan dhe *“Valle burrash”*.

Ansambli i nëntëmbëdhjetë

Grupi polifonik “Bilbilat e Kolonjës”, Gjirokastër - Shqipëri. Ky grup apo shoqatë është themeluar në vitin 2000. Shquan për pjesëmarrjet dinjitoze në festivalet folklorike në Shqipëri e gjetkë, sikundër edhe në ndonjë festival ndërkombëtar, në Greqi etj. Është një ansambël polifonik i konsoliduar për interpretimin e këngëve polifonike. Ka zëra brilantë si te burrat ashtu dhe te të dy gratë.

“Bilbilat e Kolonjës” pati një program të larmishëm, përmes këngëve të tilla si: *“Qante motra për vëllanë”*, *“Për Nënë Terezën”*, *“Era puthi malin-o”*, *“Dua të shfaq sevdanë”* dhe *“Mbi lisin e prerë”*. Sigurisht që të pesë këngët qenë të vetmet në konkurrim, të karakterit polifonik, teksa secila pati individualitet, si në melodi, ashtu edhe në alternimet e *“marrësve”*, *“hedhësve”* dhe *“pritësve”* të këngëve.

Ansambli i njëzetë

SHKA "Jahi Hasani", Çegran - Gostivar, Maqedoni. Ky ansambël, i krijuar 43 vjet më parë, është i vetmi që përfaqëson qytetin e Gostivarit. Ka objekt folklorin e pasur të trevës së Pollogut me rrethina. Është përfaqësuar në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare, në **Turqi, Zvicër, Itali, Bosnje Hercegovinë, Kroaci etj.** Koncerti shquajti për festivalitet dhe gjallëri, teksa së shumti pjesëmarrësit ishin të rinj, çka i karakterizonte dëshira për këngën dhe të vallëzuarit. Programi përbëhej nga katër njësi:

1. *"Melodi instrumentale",*
2. *"Këngë me motive nga Gostivari",*
3. *"Dasma e Çegranit",*
4. *"Valle me motive nga Pollogu".*

Nisma e programit përfaqësonte një melodi joshëse që përgjithësisht u luajt mirë, çka u dëshmuua edhe nga reagimi i spektatorëve. E një niveli të tillë ishte edhe "Kënga për Gostivarin", kënduar nga grupi me solist **Mahir Azizi**, e cila pati inkurajime edhe ngase përbënte objekt pikërisht ngulimet e atij ansambli, dukuri kjo që gjithmonë meriton stimulime.

Të dy njësitë koreografike në të cilat përparësisht do të duhej të vlerësohen përfaqësimet me toponimet Çegran dhe Pollog, u ekzekutuan përgjithësisht me dëshirë dhe pasion. Të arrira mirë qenë te djemtë dy dukuri koreografike: rrethi i mbyllur dhe gjysmërrethi, figura këto tipizuese për shtjellime mbresëlënëse. Kurse te valltaret hijeshuan ato lëvizje të larmishme në gjithë hapësirën e skenës, të cilat krijuan njëfarë ngrohtësie kërcyese.

Sfera e koreografisë së atij ansambli për mendimin tim nuk ishte burimore sipas kriterëve artistiko-shkencore të festivalit.

Ansambli i njëzetënjëtë

Ansambli autokton "Rugova", Rugovë - Pejë, Kosovë. Është i kahershëm, me tradita të pasura dhe të larmishme, një ansambël folklorik i jashtëzakonshëm.

Programi shquajti për njësi të tilla, si: *"Loja me pushkë", "Kangë me lahutë", "Valle dyshe grash", "Loja me pishtola", "Kjan syzeza për çoban", "Loja me jataganë"* dhe *"Kangë grash", të interpretuara me përsosmëri.*

Ansambli i njëzetedytë

Ansambli folklorik “Bashkimi kombëtar”, Nju Jork – SHBA. Sipas të dhënave përkatëse pjesa më e madhe e tij janë banorë të shkuar atje, ose me origjinë nga trojet e këtyre ngulimeve, pra nga Malësia e Madhe. Ansambli është themeluar në Nju Jork, në vitin 1988. Ka marrë pjesë në disa festivale në Shqipëri, Kosovë, Malin e Zi dhe Maqedoni, sikundër edhe në veprimtari të tilla ndërkombëtare që janë zhvilluar në SHBA, Gjermani etj. Në festivalin mbarëkombëtar të folklorit “*Rapsha 2017*” merr pjesë për herë të dytë pas atij të vitit 2013.

Ansambli folklorik “*Bashkimi kombëtar*”, që mban një emërprestigjioz për artin dhe kulturën tonë, u paraqit me një program folkloriko-artistik modest, të cilin e karakterizonte kryesisht tematika patriotike. Një dukuri e tillë ishte e konfirmuar përmes disa njësive të programit. Kështu, ishte kënga e kënduar në grup, “*Kombi jon’ me djep mbi gurë*”, ose një tjetër, “*Të pandarë Jug dhe Veri*”, të cilën e kënduan vëlla e motër **Engjëll** dhe **Suzana Juncaj**. Me një përmbajtje të tillë patriotike që edhe kënga “*Amaneti i gjyshit*”, kënduar nga **Valentina Ivezaj**.

Tematika e vokalitetit përfshinte edhe njëfarë suaze më të ngushtë, siç ishte kënga “*O Malësi të bekoftë Zoti!*” që u këndua nga **Jozed Juncaj**.

Pas këtyre katër njësive vokale programi përfshinte “*Valle brezash*”, që u luajt nga i gjithë grupi, teksa zotëronte formacioni me dyshe kërcimi. Këto do të ishin të pesë njësitë e programit, të cilat përgjithësisht qenë konceptuar mirë. Ashtu si ansambli pararendës, “*Gjergj Kastrioti – Skënderbeu*” i Detroitit të SHBA-së, edhe ky u prit me ovacione, kryesisht nga spektatorët e shumtë të gjakut të tyre malësor.

*

Pas përfundimit të ansamblit “*Bashkimi kombëtar*” – Nju Jork, festivali u mbyll me një koncert spektakolaro-festiv.

Juria i vlerësoi çmimet në rang ansamblesh:

Çmimi i Parë – **Ansambli “Rugova” i Pejës, Kosovë**

Çmimi i Dytë – **Grupi polifonik “Lunxhëria”, Shqipëri**

Çmimi i Tretë – **Ansambli Arbëresh i Kalabrisë, Itali**

*

Largohemi me përshtypjet më të mira nga Tuzi dhe festivali mbarëkombëtar shqiptar i folklorit *"Rapsha 2017"*, që i përfundoi punimet me sukses të merituar. Më plotësisht, do ta përcaktoja si një **festival mbarëkombëtar me "background" të madh**. Madje, një festival që kryesisht për nga organizimi, mund të matet me të tillë, deri të përmasave ndërkombëtare, të paktën me ato që kam ndjekur gjatë disa dhjetëvjeçarëve, në: Gjermani, Turqi, Itali, Rumani, Hungari, Greqi, Maqedoni, Mali i Zi, Francë, Spanjë dhe së fundmi në Slloveni.